



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

141/23

21.03.23



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0141

Data e Vendimit: 21.03.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenit 108/A par 1, par 3 si dhe paragrafi 8 pika 1 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE Uplift L.L.C, kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 21/03/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar, ankesa e Uplift L.L.C. me nr. të protokollit 2023/0141, e datës 13/03/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me datën 30.03.2022, Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit ka qenë në OSHP dhe për këtë aktivitet të prokurimit OSHP ka marrë vendimin me numër PSh. nr. 522/22 të datës 27.10.2022.

AK me datën 23.02.2023 ka publikuar B58 Njoftim për dhënie të kontratës ku sipas këtij njoftimi i rekomanduar për dhënie të kontratës është OE Uplift L.L.C Intrast SHPK.

Kundër vendimit B58 për dhënie të kontratës të datës 23.02.2023, ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim OE “Ejona”.

Autoriteti kontraktues me vendim ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Ejona” shpk dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Operatori ekonomik “Uplift L.L.C” me datën 13 mars 2023 në ora 13:45, ka dërguar në AK kërkesën për rishqyrtim me pretendimet se: *“Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren nr. 001 2022 për Prokurimin Publik. Konkretisht vendimi i 07.03.2023 është në kundërshtim edhe me vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së”*.


I njëjti me datën 16 mars 2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me numër të protokollit 141/23.

Kryetarja e OSHP-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave dhe fakteve të dorëzuara në sistemin e e-prokurimit, konstaton se ankesa e OE “Uplift LLC” është e palejuar për faktin se e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 1 të LPP-së, lidhur me nenin 3, si dhe paragrafin 8.1 të këtij neni si dhe nenin 60 të Rregullores 001/22 për prokurimin publik, sepse AK nuk ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës, dhe OE ka qenë dashur që të presë që të parashtronte kërkesën për rishqyrtim, vetëm pasi që të ishte publikuar njoftimi për dhënie të kontratës ose ndonjë vendim tjetër i AK-se.

Neni 108/A paragrafi 1 thotë: *Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlihen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

Andaj duke pasur parasysh këtë dispozitë ligjore, Kryetarja e OSHP-së vlerëson se ankesa është e palejuar dhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet nga paneli shqyrtues i OSHP-së.

Duke u bazuar në të lartcekurat, Kryetarja e OSHP-së konform nenit 105 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Uplift L.L.C.**
- **Arkivës së OSHP-së:**